



**BPrAL AAB**  
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

**FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

# MENAXHIMI I RISKUT TË PROJEKTIT

LËNDA: MENAXHIMI I PROJEKTËVE TË TI-së

Ligjërues: MSc. Artan DRESHAJ

# PROCESI I PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË PROJEKTET E TI

- ▶ Risku i projektit definohet si një ngjarje ose kusht e paqartë, që nëse ndodh, ka një efekt pozitiv ose negativ mbi objektivat e projektit.
- ▶ Risku i projektit lind nga pasiguria.
- ▶ Kjo pasiguri vjen nga përpjekja jonë për të parashikuar të ardhmen në bazë të vlerësimeve, supozimeve, dhe informacionit të kufizuar.
- ▶ Menaxhimi i riskut të projektit përfshin proceset e zbatimit të menaxhimit të riskut në planifikim, identifikim, analizë, përgjigje të planifikuara, dhe monitorim dhe kontroll në një projekt; shumica e këtyre proceseve përditësohen gjatë gjithë projektit.
- ▶ Objektivat e menaxhimit të rrezikut të projektit janë për të rritur probabilitetin e ndikimit të ngjarjeve pozitive, dhe uljen e probabilitetit dhe ndikimit të ngjarjeve negative të projektit.

# PROCESI I PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË PROJEKTET E TI - (2)

- Proceset e menaxhimit të riskut në projektet e TI-së




Figure 8.1 IT Project Risk Management Processes

# PROCESI I PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË PROJEKTET E TI - (3)

## Planifikimi i riskut

- ▶ Planifikimi i riskut është hapi i parë dhe fillon me një angazhim të vendosur të qasjes së të gjithëve për menaxhimin e riskut nga të gjithë palët e interesit të projektit.
- ▶ Ky angazhim siguron që resurse të mjaftueshme do të vendosen që të planifikojnë si duhet dhe menaxhojnë risqet e ndryshme të projektit të IT.
- ▶ Këto resurse mund të përfshijnë kohën, njerëzit, dhe teknologjinë.
- ▶ Palët e interesit gjithashtu duhet të jenë të angazhuara në procesin e identifikimit, analizës, dhe duke iu përgjigjur kërcënimeve dhe mundësive.

## Identifikimi i riskut

- ▶ Pasi angazhimit të resurseve të nevojshme, hapi tjetër përfshin identifikimin e risqeve të ndryshme për këtë projekt.
- ▶ Të dyjat, kërcënimet dhe mundësitë duhet të identifikohen.
- ▶ Kur identifikojmë kërcënimet ndaj një projekti, duhet të identifikohet qartë problemi i vërtetë, jo vetëm adresimi i një simptomë.
- ▶ Shkaqet dhe efektet e çdo rreziku duhet të kuptohen në mënyrë që të mund të përgatiten strategjitë dhe përgjigjet efektive.

# PROCESI I PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË PROJEKTET E TI - (4)

## Vlerësimi i riskut

- ▶ Pasi që risqet e projektit janë identifikuar dhe po ashtu janë kuptuar shkaqet dhe efektet e tyre, hapi tjetër kërkon që të analizojmë këto risqe.
- ▶ Përgjigjet në dy pyetje themelore janë të nevojshme:
  - ▶ Cila është mundësia që një risk i veçantë të ndodhë?
  - ▶ Cili është ndikimi mbi projektin, nëse kjo ndodh?
- ▶ Vlerësimi i riskut ofron një bazë për të kuptuar se si të merremi me risqet e projektit.
- ▶ Vlerësimi i këtyre risqeve i ndihmon menaxherit të projektit dhe aktorë të tjerë për të përcaktuar përparësitë dhe për të formuluar përgjigjet për ato risqe që ofrojnë kërcënimin më të madh ose mundësit për projektin.

## Strategjitë e riskut

- ▶ Hapi tjetër i procesit të planifikimit të riskut është për të përcaktuar se si të merremi me risqet e ndryshme të projektit.
- ▶ Një strategji e riskut të projektit do të përqendrohet në një nga këto për risqet apo kërcënimet negative:
  - ▶ Pranon ose injoron riskun.
  - ▶ Shmangni riskun plotësisht.
  - ▶ Të zvogëlojë gjasat ose ndikimin e riskut (ose të dyja), nëse ndodh risku.
  - ▶ Transferimi i riskut tek dikush tjetër (p.sh., sigurimi).

# PROCESI I PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË PROJEKTET E TI - (5)

- ▶ Qasjet për risqet apo mundësit pozitive mund të përfshijnë:
  - ▶ Shfrytëzimin
  - ▶ Ndarjen e pronësisë
  - ▶ Rritja e probabilitetit të ndikimit ose probabilitetit të ngjarjes pozitive
  - ▶ Prano dhe përfito

## Monitorimi dhe kontrolli i riskut

- ▶ Pasi që risqet e projektit janë identifikuar dhe përgjigjet e duhura janë formuluar, në hapin tjetër bëhet skanimi i mjedisit të projektit në mënyrë që të dyjat, kërcënimet dhe mundësitë e identifikuara dhe të paidentifikuara mund të ndjekin, ashtu sikurse anijet që ndjekin ekranin e radarit.

## Përgjigjet e riskut

- ▶ Monitorimi dhe kontrolli i riskut ofron një mekanizëm për skanimin e ambientit të projektit për risqet, por duhet të angazhohen resurset dhe të ndërmerren veprime pasi që një kërcënim ose mundësi është bërë e njohur.
- ▶ Këto veprime zakonisht ndjekin strategjinë e planifikuar të riskut.

# IDENTIFIKIMI I RISQEVE NË PROJEKTET E TI

- ▶ Identifikimi dhe kuptimi i risqeve që do të ndikojnë në një projekt nuk është gjithmonë një detyrë e thjeshtë.
- ▶ Shumë risqe mund të ndikojnë në një projekt në mënyra të ndryshme dhe gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së projektit.
- ▶ Bërthama e kornizës së riskut të një projekti të TI është MOV, ose vlerat e matshme të organizatës.
- ▶ Shtresa tjetër e kornizës përfshin objektivat e projektit në terme të fushëveprimit, cilësisë, orarit, dhe buxhetit.
- ▶ Shtresa e tretë fokusohet në burimet e riskut të projektit të TI.
- ▶ Shtresa tjetër fokusohet në atë se burimet e riskut janë brenda apo jashtë projektit. Është e rëndësishme për të bërë këtë dallim për shkak se një menaxher i projektit është përgjegjës dhe i përgjegjshëm për të gjitha projekt risqet e brendshme të projektit.
- ▶ Shtresa e pestë e strukturës së administrimit të riskut të projektit të IT përfshin tri lloje të ndryshme të risqeve: risqet e njohura, risqet e njohura - të panjohura, dhe risqet e panjohur-panjohur.




Figure 8.2 IT Project Risk Identification Framework



# MENAXHIMI I RISKUT TË PROJEKTIT

► **PYETJE PËR KËTË KAPITULL?**